V E N D I M
Nr.466, datë 31.12.1990

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 228, DATË 11.7.1990 "PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE DHE TË ARTIZANATIT"

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.228, datë 11.7.1990, pika 5 ndryshohet si vijon:

"Veprimtaria private në fushën e shërbimeve, të artizanatit, të tregtisë etj. mund të zhvillohet mbi baza familjare dhe ortakërie. Personat që do të ushtrojnë këtë veprimtari, duhet të kenë lejen e ushtrimit të profesionit dhe librezën shëndetësore, të përballojnë detyrimin financiar taksë për të ardhurat që realizojnë, dhe të sigurojnë veten për pensionin e sëmundshmërinë. Tarifat mbi të ardhurat e tyre caktohen nga Ministria e Financave".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI